



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, vvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 15., 16.2., dhe 16.4.b. të Ligjit për Planifikim të Hapsirës nr. 2003/14, nenit 4. par.3. të Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e LPH, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e LPH mbi elementet e themelore të PZHU, nr. 34, dt. 26.12/2003 dhe UA për zbatimin e LPH mbi elementet themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 17. pika a, b, c, d dhe e, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 30/L-040, nenit 38.1. (b,c,d.) të dhe nenit 81. (h.i.) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të pikës IV. dhe V. të Vendimit mbi miratimin e Planit Zhvillimor Komunal: "Gjilani - 2015+", nr. 01-11736 të dt. 30.10/2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 16.10.2012, miraton këtë:

V E N D I M

Për qasjen e hartimit të Planit Zhvillimor Urban për Subqendrën Zhegër

Neni 1

Me këtë propozim Vendim i qaset hartimit të Planit Zhvillimor Urban për Subqendrën: Zhegër (në tekstin e mëtejshëm: PZHU: "Subqendra Zhegër").

Neni 2

Me këtë propozim vendim përkufizohet hapsira e tërsishme e PZHU: "Subqendra Zhegër", e cila përfshinë këto Zona Kadastrale dhe ate: Z.K-Zhegër; Z.K-Llashticë; Z.K-Lladovë; Z.K-Muçibabë; Z.K-Nosalë; Z.K-Dunav; Z.K-Çelik; Z.K-Shurdhan; Z.K-Pidiq; Z.K-Stançiq; Z.K-Lipovicë; Z.K-Burincë; Z.K-Goden i Vogël, me sipërfaqe rreth 9. 986.81 ha në tërsi sipas paraqitjes grafike, e cila është pjesë përbërse e këtij propozim Vendimi.

Neni 3

Me PZHU- "Subqendra Zhegër" do të planifikohet rregullimi i hapësirës në kontekst të realizimit të PZHK: "Gjilani -2015+" dhe harmonizimin e zhvillimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësitë investive për të arritur kushte optimale të zhvillimit, organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ruajtjen e tokës bujqësore, ndërtimit të objekteve banimore-afariste dhe destinime tjera si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës publike dhe infastukturës teknike komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Komunës së Gjilanit, duke mos cenuar përmbajtjet e realizuara me planet për rreth.

Neni 4

PZHU-"Subqendra Zhegër", duhet të përmbaj edhe elementet e Planit Rregullues Urban.
PZHU-"Subqendra Zhegër" përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike;

Neni 5

Gjatë hartimit të këtij plani, veqmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapsirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufinjëve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke patur parasysh kushtet urbanistiko teknike dhe hapsinore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të asrimit, edukimit, shëndetsisë, mirëqenjes sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse (rrugëve, gjelbrimit public, hapsirave të lira, rrjeteve të ujësjellsit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, rrjetit të përquesve elektrik, telekomunikes, optik etj);
- **Organizimin e ndërtimit të objekteve të karakterit të veçant - vendkalimi kufitar me objekte dhe përmbajtje përcjellëse si dhe objekte tjera;**
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor;
- ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të resurseve dhe pasurive natyrore,
- mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapsinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm publik;

Neni 6

Bartës i Menagjimit të procesit të hartimit të këtij plani, caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan.

Neni 7

Hartues i këtij Plani do të jetë Sektori i Planifikimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e komunës së Gjilanit, në mbështetje të UN-Habitat-it dhe ECMS-së.

Neni 8

Komuna, sipas nevojës mund të angazhojë edhe ekspert të jashtëm për fusha përkatëse këtij Plani.

Neni 9

Draftdokumenti final- Projekti i këtij Plani, duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente.

Koha dhe vendi për shqyrtim publik dhe dhënjen e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

Neni 10

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

Financimi mundë të bëhet edhe nga OJQ-të, partneriteti publiko-privat, donatorët dhe komuniteti.

Neni 11

PRrU do të hartohet për periudhën afatmesme 10 vjeqare.

Neni 12

Mbi zbatimin e këtijë propozim Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan.

13.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

i Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: PZHU-"Subqendra Zhegër",

Bazë juridike për propozimin për miratimin e Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Zhvillimor Urban për PZHU: "Subqendra Zhegër", janë dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor me ndryshimet e LPH, dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e LPH mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban, Ligji për Vetëqeverisjen lokale, Statuti i Komunës së Gjilanit, Vendimi i KK-ës Gjilan për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal: "Gjilani - 2015+", nr. 01.11736, dt. 30.10 2008.

PZHU: "Subqendra Zhegër", është një tërësi hapësinore kompakte e ndërlidhur dhe e shtrir nga pjesa jugore e Qytetit të Gjilanit dhe me interefime të drejtëpërdrejta në kufirin shtetror në mes Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë, si dhe komunën e Vitisë dhe komunën e Parteshit-Pasjanit. Kjo hapësirë ka një sipërfaqe rreth **9.986.81** hektar, e shtrirë në vise të ulta dhe vise kodrinore-malore shumë pak të banuara me tendencë të vazhdueshme të zhvendosjes në zonat e ulta, me koncentrim të banimit individual kryesisht në pjesët e rrafshata përgjatë rrugëve lokale, me tendencë të zhvillimit të pakontrolluar të mëtejshëm, kryesisht në toka të rrafshata bujqësore, që në mënyrë të drejtëpërdrejtë, zvoglon sipërfaqen e tokës bujqësore dhe ndikon në degradimin e tokave për rreth.

PZHU: "Subqendra Zhegër", është një zonë dhe përmbajtje shumë komplekse multidisiplinare dhe përmbledhje e të gjitha aktiviteteve dhe dukurive që ndodhin apo zhvillohen brenda kësaj hapësire, dhe kjo zonë duhet ndërtohet në bazë të një strategjie afatgjate dhe afatmesme të planifikimit dhe zhvillimit duke filluar nga analiza e gjendjes ekzistuese të të gjitha fushave tematike sferave me ndikim siqë janë: ,
-sistemi shoqëroro-ekonomik, / arsimi, shkenca, shëndetësia, kultura, sporti, rekreacioni, informimi etj./;
-teritori dhe struktura gjeografike dhe gjeofizike; / hapsira, konfiguracioni, të dhënat inxhinjeriko-gjeologjike, pedologjike, karakteristikat seizmike, bazat gjeodezike, hidrologjike, etj/

-popullsia / shtrirja, dendësia, tendencat migruese-demigruese/
-infrastruktura komunalo-banesore / rrjeti rrugor, elektricitet, PTT, ujësjellësit, kanalizimit, shtrirja e vendbanimeve dhe niveli i ndërtimeve/;

-tërësitë ambientale dhe mjedisore;

-ekonomia (mikro dhe makro planet) me të gjitha përmbajtjet e saja, industria, energjetika dhe teknologjitë e larta, ambienti jetësor, resurset e papërsëritshme natyrore (resurset të cilat nuk regjenerohen), trashigimia kulturore-historike;

-infrastruktura si kompleks domethënjesh, komunikative, hapsinore dhe urbanistike në kuptimin e planifikimit dhe zhvillimit si dhe

-nëndisiplina të tjera të cilat në mënyrë direkte ose indirekt ndikojnë në planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm bashkohor.

PZHU: "Subqendra Zhegër", do të përmbajë një mori të elementeve të planit rregullues urban edhe normativat teknike, zgjidhjet urbane dhe rregullative varësisht nga lokacioni, përkatësisht fshati, vendbanimi, lagjësia dhe lokacione të caktuara që përbëjnë një tërësi urbanistike, rregullat e shfrytëzimit të tokës ndërtimore dhe të ndërtimit të objekteve të karakterit të përgjithshëm dhe të veçant public, infrastrukture komunale si dhe rregulla të tjera të cilat mundësojnë ndërtime të ndara për investitor të ndryshëm, duke rrespektuar standardet më bashkohore të qëndrueshme dhe funksionale për rregullimin e hapësirave të fshatrave dhe vendbanimeve.

Pra në parim në bazë të këtij Plani hartohen /definojnë/ kushtet urbanistiko-teknike për të gjitha ndërtimet dhe projektet tjera në atë lokalitet, andaj ky plan është plani kryesor më i rëndësishëm për çdo fshat dhe vendbanim.

Me këtë Plan do të krijohen kushte për orientimin e zhvillimeve më të detajuara në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal-"Gjilani 2015+" dhe politikat në fushat e: Zhvillimit Ekonomik, Demografisë dhe Qështjeve Sociale, Infrastrukturës dhe Transportit si dhe Shfrytëzimit të Tokës dhe Mjedisit.

Gjilan, Qershor / 2012.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Zonat kadastrale të subqendrës Zhegra



1 : 100.000